

**AKT THEMELIMI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI  
TË KUFIZUAR  
Guxo Sh.p.k.**

- Z. Pëllumb Hala, atësia Zenel datëlindje 02.01.1966 qytetar i Republikës së Shqipërisë, me vendlindje Tiranë dhe banim Tiranë.

kam vendosur të nënshkruaj Aktin e Themelimit e mëposhtëm të një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar (më poshtë "Shoqëria"), aktiviteti i së cilës rregullohet nga legjislacioni shqiptar në fuqi dhe Statuti i saj, i cili është pjesë përbërëse e këtij akti.

**Neni 1 - Emërtimi**

Emërtimi i Shoqërisë është **Guxo**

**Neni 2 - Selia**

Selia e Shoqërisë është Rr. Shyqyri Bërçolli, Pall. Aurora, Kati 2, Tiranë.

**Neni 3 - Kohëzgjatja**

Kohëzgjatja e veprimtarisë së Shoqërisë do të jetë me një afat të pacaktuar.

**Neni 4 - Objekti i shoqërisë**

Ne fushen e minierave Shoqëria do të kryejë : kerkimin, zbulimin, studimin, projektimin, konsulencën, sipermarrjen zbatuese dhe/ ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe / ose jopublike të minierave me karakter kerkimi, zbulimi, shfrytëzimi dhe / ose administrimi publik dhe / ose privat si: ndertimin dhe shfrytëzimin e minierave publike dhe private për të tera llojet e mineraleve, shfrytëzimin e burimeve natyrore të ujërave minerale, të pijshme apo për qëllime industriale, si dhe të burimeve natyrore të ujërave termale. Në këtë drejtim shoqëria do të aplikojë dhe marrë cdo lloj leje të nevojshme dhe të leshuar nga organet kompetente, për kerkimin zbulimin, studimin, shfrytëzimin, përdorimin apo kryerjen e të gjitha veprimtarive të lejuara nga ligjet në fuqi, në lidhje me të cdo / dhe të gjitha pasuritë e tokës dhe nentokës, hapja dhe shfrytëzimi i minierave dhe ndertimi i fabrikave apo impianteve të\* pasurimit e perpunimit të produkteve që do të merren nga shfrytëzimi i minierave, i burimeve natyrore të ujërave minerale dhe termale; të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, të grupit të mineraleve ndertimore të mineraleve të cmuara e gjysem të cmuara, radioaktive, etj.

Në fushën e ndertimit Shoqëria do të kryejë : kerkimin, zbulimin, studimin, projektimin, konsulencën, sipermarrjen zbatuese dhe/ ose investimin, sipas rastit, për realizimin me fonde publike dhe / ose jopublike të veprave me karakter shfrytëzimi, kerkimi, zbulimi, shfrytëzimin dhe / ose administrimi publik dhe / ose privat si: ndertimin e ndertesave publike dhe private, rrugëve, urave, tuneleve, mbikalimeve e nenkalimeve, dhe të gjitha veprave të tjera madhore, ujesjellesave , ndertimin dhe rehabilitimin e veprave ujëtare, objektet turistike, objektet e kultit, rrjetet inxhinierike, objektet industriale, të gjitha restaurimet në përgjithësi, rikonstruksione të veprave të artit, montimet e konstruksioneve metalike ; si dhe cdo ndertim tjetër i cili në përfundim përben send të paluajshëm sipas nenit 142 të Kodit Civil për shkak të trupezimit në mënyrë të qëndrueshme e të vazhdueshme me token ose ndertesën ku është vendosur.

Në fushën e tregtisë Shoqëria do të kryejë : Tregtimin dhe import-exportin të të gjitha metaleve, të grupit të mineraleve metalore, jometalore, qymyret dhe bitumet, të grupit të mineraleve ndertimore, të mineraleve të cmuara e gjysem të cmuara, radioaktive ; të të gjithë mallrave, duke përfshirë por pa u kufizuar në industriale, ushqimore, mjekësore , të mjeteve kryesore dhe ndihmëse të prodhimit, të



makinerive, etj.

### **Neni 5 - Kapitali themeltar**

- 5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë është Lekë 100,000 (njëqindmijë) i cili nuk është i paguar.
- 5.2 Kapitali themeltar i shoqërisë përbëhet nga 1 kuotë, me vlerë nominale sipas kontributit të ortakut të vetëm në kapitalin themeltar të Shoqërisë percaktuar në nenin 6 (gjashtë) të këtij Akti.

### **Neni 6 - Kontributet**

6.1 Kontributi në kapitalin e shoqërisë është si më poshtë:

- Z. Pëllumb Hala, atësia Zenel datëlindje 02.01.1966 qytetar i Republikës së Shqipërisë, me vendlindje Tiranë dhe banim Tiranë të cilit i përket një kuotë, me vlerë nominale Leke 100,000 (njëqindmijë) që i korespondon 100% i kapitalit të Shoqërisë.

### **Neni 7 - Transferimi i kuotave**

Kuotat i transferohen të tretëve sipas parashikimeve të Statutit.

### **Neni 8 - Administrimi**

8.1 Me këtë akt emërohet 1 (një) Administratorë i Shoqërisë personi si më poshtë:

- Z. Pëllumb Hala, atësia Zenel datëlindje 02.01.1966 qytetar i Republikës së Shqipërisë, me vendlindje Tiranë dhe banim Tiranë, cili emërohet për një periudhë 5 (pesë) vjeçare.

8.2 Administratori do të ushtrojë të gjitha kompetencat e administrimit të zakonshëm, në përputhje me parashikimet e nenit 95 të ligjit nr. 9901, datë 14 prill 2008 "Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare" dhe nenit 14 të Statutit.

8.3 Administratorit i jepen të gjitha kompetencat e nevojshme për të kryer të gjitha formalitetet dhe veprimet e parashikuara për themelimin e Shoqërisë sipas legjislacionit në fuqi. Për këtë qëllim, Administratori, mund t'u drejtohet për ndihmë të tretëve ose konsulentëve të cilëve mund të delegojnë në tërësi ose pjesërisht kryerjen e aktivitetit të sipërpërmendur.

8.4 Administratori është gjithashtu i autorizuar të veprojë në emër të Shoqërisë në formim e sipër deri në regjistrimin e saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit. Ai është gjithashtu i autorizuar, të firmosi të gjitha aktet dhe të marrë përsipër detyrime në emër të Shoqërisë që rrjedhin prej momentit të regjistrimit të saj si edhe ka të drejtë t'i delegojë kompetencat e tij personave të tjerë.

### **Neni 9- Gjuha**

Ky Akt Themelimi është hartuar në 3 (tre) kopje në gjuhën shqipe.

### **Neni 10 - Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

10.1 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me interpretimin dhe/ose zbatimin e këtij statuti si edhe ato që mund të lindin në përgjithësi midis ortakëve (përveç atyre personale apo jashtë Shoqërisë) ose midis një apo më shumë ortakëve dhe Shoqërisë, do të zgjidhen në mënyrë miqësore dhe do të diskutohen në mënyrë të drejtpërdrejtë ndërmjet palëve të interesuara.

10.2 Në rast se nuk arrihet në një zgjidhje miqësore të mosmarrëveshjes, ato do t'i besohen Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë

ORTAKU I VETEM

Pëllumb Hala

14.12.2023

